

AKT THEMELIMI

I

SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

" Enzo Group Shpk " SH.P.K

Sot, më datë 28.08.2024,

Brikeno Shegaj, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 26.08.1987, lindur në Shkoder, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 037512939 dhe Nr. Personal 1708261000, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të;

dhe

Jozefina Mema, shtetase shqiptare, e ditëlindjes 17.09.1988, lindur në Bushat, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 035037045 dhe nr. Personal I85917075U, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të.

NENI 1

Themelimi

Emri i shoqërisë është "**Enzo Group Shpk**" Sh.P.K. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve dhe jo vetëm, do të shënohet emri "**Enzo Group Shpk**" Sh.P.K.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Objektivi i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e Import-eksport, ruajtje, shpërndarje, shitje me shumice e pakice të artikujve farmaceutik dhe parafarmaceutik, shtesave ushqimore dhe produkteve bimore, produkteve kozmetike, bimeve medicinale, barnave narkotike dhe psikotrope, pajisje mjekesore.

NENI 3

Emri dhe vula e Shoqërisë

Shoqëria del në qarkullim me emrin "**Enzo Group Shpk**" Sh.p.k dhe kompania do ketë vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Objektivi i shoqërisë do jetë: Import-eksport, ruajtje, shpërndarje, shitje me shumice e pakice të artikujve farmaceutik dhe parafarmaceutik, shtesave ushqimore dhe produkteve bimore, produkteve kozmetike, bimeve medicinale, barnave narkotike dhe psikotrope, pajisje mjekesore.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Shkodres me adresë: Berdice e Siperme, Rruga Kryesore, zona kadastrale 1159, nr pasurie 295/1.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqërisë është në vlerën **3,000,000** (Tre milion) lekë, i ndarë në 2 kuota.

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare me emrin "**Enzo Group Shpk**" **Sh.P.K** zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Brikeno Shegaj, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 26.08.1987 , lindur në Shkoder, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 037512939 dhe Nr. Personal *I708261000* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 60% te kapitalit (1,800,000 leke).

Jozefina Mema, shtetase shqiptare, e ditëlindjes 17.09.1988 , lindur në Shkoder, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 035037045 dhe nr. Personal *I85917075U* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 40% te kapitalit (1,200,000 leke).

Kapitali themeltar do te shlyhet plotësisht në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë dhe hapjen e niptit dhe llogarise bankare. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve në kapitalin themeltar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit Nr 9901, datë 14/04/2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - Organi më i lartë vendimarrës.

Administratori - Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8

Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

NENI 9

Caktimi i Administratorit

Administrator caktohet për një afat 5-vjeçar, **Brikeno Shegaj**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 26.08.1987, lindur në Shkoder, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 037512939 dhe Nr. Personal *I708261000*.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjisllacionin në fuqi.

NENI 10



Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritje e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 13

Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen në Gjykata kompetente.

NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, nënshkruhet pa vërejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

Brikeno Shëgaj

Brikeno Shëgaj



Jozefina Mema

Jozefina Mema

